



**Pyetjet më të shpeshta për  
regjistrimin e Institucioneve  
Mikrofinanciare dhe  
Institucioneve Jobankare**

## Përmbajtja

Pyetjet më të shpeshta për regjistrimin e IMF-ve/IFJB-ve.....	5
<b>Të përgjithshme.....</b>	<b>5</b>
1. Kush është BQK? .....	5
2. Çfarë janë institucionet financiare?.....	5
3. Çfarë është institucion mikrofinanciar? .....	5
4. Çfarë është institucion financiar jobankar? .....	5
5. Kur mund ta quaj veten IMF apo IFJB?.....	6
6. A mund të ketë IMF apo IFJB status tjetër përveç shoqërisë aksionare? .....	6
7. Çfarë është regjistrimi? .....	6
8. Çfarë është depozita? .....	6
9. A mund të angazhohen IMF-të dhe IFJB-të në pranimin e depozitave? .....	6
10. Çfarë veprimtari financiare janë të lejuara për IMF-të dhe IFJB-të në Kosovë? .....	6
11. Ku duhet të aplikojë për t'u licencuar/ regjistruar si IMF apo IFJB? .....	7
12. A ka rëndësi nëse unë nuk jam me qendër në Kosovë? .....	7
13. Sa IMF dhe IFJB janë të licencuara/ regjistruara në Kosovë? .....	7
14. A janë të gjitha IMF-të e njëjta?.....	7
15. A janë të gjitha IFJB-të e njëjta? .....	7
16. Nuk jam i sigurt nëse duhet të jem një IMF apo IFJB, ku mund të marrë më shumë informacion mbi alternativat? .....	7
17. Kush duhet të jetë prezentë në takimin informues nga ana e aplikuesit? .....	8
18. Në takimin informues a mund të marrin pjesë vetëm përfaqësuesit e aksionarëve? .....	8
19. Cilët janë aksionarët kryesor të IMF-së apo IFJB-së? .....	8
20. Çfarë duhet të përgatitet për takimin informues? .....	8
21. Kur mund të fillojë të përgatisë aplikacionin për regjistrimin e një IMF-je apo IFJB-je? .....	8
22. Çfarë dokumentesh duhet të dorëzojë si aplikacion për licencim/ regjistrim të një IMF-je apo IFJB-je? .....	8
23. Sa shpejt mund të bëhem IMF apo IFJB? .....	8
24. Po sikur firma ime tashmë të jetë e licencuar/ regjistruar? .....	9
<b>Para aplikimit.....</b>	<b>9</b>
25. A duhet të kaloj nëpër procesin e para-aplikimit? .....	9
26. Çka është plani i biznesit? .....	9
27. A janë ndërveprimet e mia me ju konfidenciale? .....	9

28.	<i>Sa është kapitali minimal i kërkuar për hapjen e një IMF-je apo IFJB-je të re?</i> .....	10
29.	<i>Kush mund të jetë aksionar i IMF-së apo IFJB-së së re?</i> .....	10
30.	<i>Çfarë prejardhje mund të kenë fondet për investim në formë të kapitalit?</i> .....	10
31.	<i>A mund të lëshojmë aksione në këmbim të shërbimeve?</i> .....	10
32.	<i>Sa anëtar mund të ketë bordi i drejtorëve të një IMF-je apo IFJB-je?</i> .....	10
33.	<i>A munden aksionarët të jenë anëtarë të bordit të drejtorëve?</i> .....	10
34.	<i>Cilët drejtorë mund të konsiderohen joekzekutiv?</i> .....	11
35.	<i>A mundet kryeshefi ekzekutiv të jetë anëtar i bordit të drejtorëve?</i> .....	11
36.	<i>Cilët drejtorë mund të konsiderohen të pavarur?</i> .....	11
37.	<i>Çfarë do të thotë i përshtatshëm dhe i dubur për drejtorët dhe menaxherët e lartë?</i> .....	11
38.	<i>Kur, ku dhe si dubet ta dorëzojë aplikacionin për licencim/ regjistrim të një IMF-je apo IFJB-je?</i> .....	11
39.	<i>Ku mund të lexoj më shumë për qasjen e BQK-së për regjistrimin e IMF-ve apo IFJB-ve?</i> .....	11
40.	<i>A kam nevojë të punësoj këshilltarë ose konsulent të jashtëm për plotësimin e dokumentacionit për aplikim dhe kritereve tjera për licencimin/ regjistrimin e një IMF-je apo IFJB-je?</i> .....	11
41.	<i>A mund të rekomandoni ndonjë këshilltar ose konsulent të jashtëm?</i> .....	11
42.	<i>A mund t'i sjell këshilltarët e mi në takimet me ju?</i> .....	12
43.	<i>A specifikoni cilat sisteme të TI dubet të përdorni?</i> .....	12
44.	<i>A mund të rekomandoni ndonjë sistem/ ofrues të TI-së?</i> .....	12
45.	<i>Çfarë dubet të bëj nëse në ndërkohë gjatë aplikimit gjërat ndryshojnë?</i> .....	12
46.	<i>Sa është tarifa e licencimit bankar?</i> .....	12
47.	<i>Ku mund të gjej detajet e tarifave të aplikimit?</i> .....	12
48.	<i>Pse dubet të paguaj një tarifë?</i> .....	12
<b>Pas aplikimit</b> .....		<b>12</b>
49.	<i>Çfarë ndodhë pas aplikimit në BQK për licencim/ regjistrim si IMF apo IFJB?</i> .....	12
50.	<i>Sa zgjatë vlerësimi i aplikacionit për licencim/ regjistrim si IMF apo IFJB?</i> .....	13
51.	<i>Cilat kushte dubet të plotësohen në mënyrë që aplikacioni për licencim/ regjistrim si IMF apo IFJB të miratohet në BQK? ..</i>	13
52.	<i>A ka ndonjë kusht tjetër që merret parasysh nga BQK si kriter për licencim/ regjistrim në BQK?</i> .....	14
53.	<i>Çfarë ndodhë nëse ndonjëra nga informatat e dorëzuara me aplikacion ndryshon gjatë periudhës së vlerësimit të aplikacionit tim në BQK?</i> .....	14
54.	<i>A mund të apeloj nëse kërkesa për licencë/regjistrim refuzohet?</i> .....	14
55.	<i>A mund të filloj organizimin para licencimit/ regjistrimit?</i> .....	14

56. Nëse institucioni është i autorizuar për të ushtruar veprimtari financiare, a mund të vazhdojë të ushtrroj atë veprimtari edhe gjatë procesit të aplikimit?.....14

## Pyetjet më të shpeshta për regjistrimin e IMF-ve/IFJB-ve

Pyetjet më të shpeshta që BQK pranon nga të interesuarit për aplikim për regjistrim të Institucioneve Mikrofinanciare (IMF) dhe Institucioneve Financiare Jobankare (IFJB) janë organizuar në kategoritë e mëposhtme:

- Të përgjithshme;
- Para aplikimit;
- Pas aplikimit;
- Licencimi/Regjistrimi.

### Të përgjithshme

#### 1. *Kush është BQK?*

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) është një institucion publik i pavarur dhe objektivi parësor i saj është nxitja dhe ruajtja e një sistemi të qëndrueshëm financiar si dhe një sistemi efikas të pagesave. Është autoriteti i vetëm për licencimi, rregullim dhe mbikëqyrje të institucioneve financiare në Kosovë. Përgjegjësitë dhe objektivat e BQK-së janë të përcaktuara në Ligjin Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (linku <http://www.bqk-kos.org/repository/docs/2010/Ligji%20per%20BQK-ne.pdf>, më tutje ligji për BQK) si dhe Ligjin Nr. 04/L-093 për bankat institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare (linku <http://www.bqk-kos.org/repository/docs/2012/Ligji%20per%20bankat%20IMF.pdf> më tutje ligji për banka).

#### 2. *Çfarë janë institucionet financiare?*

Institucione Financiare nënkupton subjektet si: banka, kompani të sigurimeve, fonde pensionale, institucione mikrofinanciare, institucione financiare jobankare, ndërmjetësues në sigurime, trajtues të dëmeve si dhe subjekte tjera juridike që ushtrojnë aktivitete financiare siç përcaktohet me legjislacionin në fuqi dhe sipas të cilit Bankës Qendrore i është dhënë autoritet për licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e tyre.

#### 3. *Çfarë është institucion mikrofinanciar?*

Institucion Mikrofinanciar (IMF) është person juridik i organizuar si shoqëri aksionare sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare, veprimtari primare e të cilit është dhënia e kredive dhe ofrimi i një numri të kufizuar të shërbimeve financiare për mikro dhe subjektet e vogla juridike, ekonomitë familjare me të hyra të ulëta dhe personat me të hyra të ulëta.

#### 4. *Çfarë është institucion financiar jobankar?*

Institucion financiar jobankar (IFJB) është person juridik që nuk është bankë e as institucion mikrofinanciar, që është regjistruar nga BQK-ja sipas Ligjit për Bankat, IMF dhe IFJB, për t'u angazhuar në një ose më tepër nga veprimtaritë vijuese: dhënie e kredive, hyrjen në hua dhe kontrata qiradhënieje financiare-lizingu, në nënshkrimin, tregtimin, ndërmjetësimin ose shpërndarjen e letrave me vlerë, veprimin si shoqëri

investuese ose këshilltar i investimeve apo ofrimin e shërbimeve të tjera financiare siç janë këmbimi valutor; kredit kartat; faktoringun ose garancitë, ose shërbime të tjera financiare, edukuese-trajnuese, këshillëdhënëse dhe operacionale, si dhe veprimtari të tjera sipas përcaktimit nga BQK-ja.

5. *Kur mund ta quaj veten IMF apo IFJB?*

Asnjë person nuk mund të angazhohet në biznesin e një institucioni mikrofinanciar pa u regjistruar së pari në BQK sipas dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-093 për bankat institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare dhe pa qenë gjatë gjithë kohës në pajtueshmëri me këtë ligj dhe me rregulloret dhe urdhëresat në fuqi të nxjerra nga BQK-ja. Emrat e domain-it (web faqes) dhe adresat e emailit kontrollohen në mënyrë të ngjashme dhe ju duhet të keni kujdes në përdorimin e fjalëve të ndjeshme duke përfshirë fjalën bankë, IMF apo IFJB.

6. *A mund të ketë IMF apo IFJB status tjetër përveç shoqërisë aksionare?*

Institucionet Mikrofinanciare nuk mund të keni status tjetër përveç shoqërisë aksionare, ndërsa Institucionet Financiare Jobankare mund të regjistrohen edhe si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (SH.P.K.).

7. *Çfarë është regjistrimi?*

Regjistrimi është autorizim i lëshuar nga BQK-ja dhe dhënien e të drejtës për tu marrë me veprimtaritë e specifikuar sipas atij autorizimi.

8. *Çfarë është depozita?*

Depozita nënkupton shumën e parave që i paguhet një banke nga një person ose subjekt juridik, e cila pranohet nga banka me kusht që të kthehet në tërësi, me ose pa interes a prim qoftë me kërkesë ose në kohën e dakorduar me atë person ose subjekt juridik.

9. *A mund të angazhohen IMF-të dhe IFJB-të në pranimin e depozitave?*

Institucionet Mikrofinanciare mund të angazhohen në mbledhjen e depozitave vetëm pasi që BQK të ketë aprovuar një gjë të tillë për IMF-në përkatëse. Mirëpo, në asnjë rast një IMF nuk mund të angazhohet në mbledhje e depozitave që kalojnë pesëdhjetë përqind (50%) të suficitit të kapitalit të saj ose shumën maksimale prej njëqind e njëzetepesëmijë (125,000) euro, cilado që të jetë më e vogël.

Ndërsa Institucionet Financiare Jobankare nuk mund të angazhohen në pranimin e depozitave.

10. *Çfarë veprimtari financiare janë të lejuara për IMF-të dhe IFJB-të në Kosovë?*

Veprimtaritë financiare të lejuara për IMF-të janë përcaktuar në nenin 93 të Ligjit nr. 03/L-093 për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare. Me rastin e regjistrimit në BQK, IMF-të angazhohen në të gjitha aktivitetet e lejuara në këtë nen.

Veprimtaritë financiare të lejuara për IFJB-të janë përcaktuar në nenin 94 të Ligjit nr. 03/L-093 për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare. Për dallim nga institucionet tjera, IFJB-të angazhohen vetëm në ato veprimtari për të cilat ka miratim në BQK. Me kalimin e kohës, IFJB-të mund të kërkojnë miratim në BQK për ushtrimin e veprimtarive shtesë.

*11. Ku duhet të aplikojë për t'u licencuar/regjistruar si IMF apo IFJB?*

Për tu licencuar/regjistruar si IMF apo IFJB në Republikën e Kosovës, ju duhet të kontaktoni Departamentin e Licencimit dhe Standardizimit, përmes emailit ([Licencimi@bqk-kos.org](mailto:Licencimi@bqk-kos.org)) apo telefonit (+381 38 222 055), ku do të merreni udhëzimet e nevojshme për aplikim. Përveç udhëzimeve të nevojshme, DLS do të ju informoj se para se të fillohet me procesin e aplikimit mbajtja e takimit informues me përfaqësuesit e BQK është e obliguar.

*12. A ka rëndësi nëse unë nuk jam me qendër në Kosovë?*

BQK i mirëpret kërkesat nga çdo institucioni financiar të ri me një model biznesi të shëndoshë pavarësisht se ku kanë institucionin “amë” të themeluar. Nëse ju jeni një institucion financiar me seli në mbarë botën ju mund të veproni në Kosovë si një filiale ose degë (ose të dyja).

*13. Sa IMF dhe IFJB janë të licencuara/regjistruara në Kosovë?*

IMF-të dhe IFJB-të e licencuara/regjistruara të ushtrojnë veprimtari financiare në Republikën e Kosovës mund t'i gjeni në këtë link. <http://bqk-kos.org/index.php?id=20>.

*14. A janë të gjitha IMF-të e njëjta?*

Të gjitha IMF-të e licencuara/regjistruara në Republikën e Kosovës, mund të ushtrojnë veprimtaritë financiare të përcaktuara në nenin 93 të Ligjit nr. 04/L-093 për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare.

*15. A janë të gjitha IFJB-të e njëjta?*

Të gjitha IFJB-të e licencuara/regjistruara në Republikën e Kosovës, mund të ushtrojnë veprimtaritë financiare të përcaktuara në nenin 94 të Ligjit nr. 04/L-093 për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare për të cilat ka miratim paraprak specifik për secilin aktivitet.

*16. Nuk jam i sigurt nëse duhet të jem një IMF apo IFJB, ku mund të marrë më shumë informacion mbi alternativat?*

Të interesuarit për regjistrim si IMF dhe IFJB, në varësi të planit të biznesit ose veprimtarive që planifikojnë ti ndërmarrin fillimisht duhet të vlerësojnë nëse themelimi si IMF apo IFJB është opsioni më i përshtatshëm për ta. Dallimi në mes të IMF-ve dhe IFJB-ve lidhet me veprimtaritë e lejuara për këto institucione. Nëse synohet angazhimi vetëm në veprimtarinë e kredidhënies dhe veprimtaritë e lidhura me kredidhënie si dhe marrjen e depozitave për kreditim të segmenteve të caktuara apo individëve që banojnë në një pjesë specifike të vendit apo nëse synohet kreditimi i ndërmarrjeve të vogla lokale ose organizatave jofitimprurëse, krijimi i një IMF-je mund të jetë një alternativë më e përshtatshme.<sup>1</sup> Ndërsa nëse planifikohet angazhimi edhe në veprimtaritë tjera përveç atë të kreditimit, siç janë: shërbimi i pagesave, lizingut, faktoringu etj, krijimi i një IFJB-je mund të jetë një alternativë më e përshtatshme.<sup>2</sup> Përfundimisht të interesuarve për aplikim i'u sygjerohet referimi informatave më të hollësishme për secilën nga alternativat në shtojcën III -

---

<sup>1</sup> IMF-të të cilat planifikohet të angazhohen në pranimin e depozitave, përveç regjistrimit si IMF, duhet të marrin edhe miratimi paraprak IMF-të të cilat planifikojnë të angazhohen në pranimin e depozitave, përveç regjistrimit si IMF, duhet të marrin edhe miratim paraprak për këtë veprimtari. Megjithatë pranimi i depozitave është veprimtari e kufizuar ....

<sup>2</sup> IFJB-të nuk janë të lejuara të angazhohen në pranimin e depozitave.

Alternativat ndaj Licencimit Bankar në Manualin e Regjistrimit të IMF-ve dhe IFJB-ve, për të parë cila është alternativa më e përshtatshme për vizionin e tyre.

*17. Kush duhet të jetë prezentë në takimin informues nga ana e aplikuesit?*

Në takim duhet që të marrin pjesë të gjithë aksionarët kryesor të IMF-së apo IFJB-së së re të propozuar.

*18. Në takimin informues a mund të marrin pjesë vetëm përfaqësuesit e aksionarëve?*

Jo, në takim duhet të jenë prezent të gjithë aksionarët kryesor të IMF-së apo IFJB-së së re të propozuar.

*19. Cilët janë aksionarët kryesor të IMF-së apo IFJB-së?*

Aksionar kryesor është çdo person (juridik dhe fizik) që posedon në mënyrë të drejtpërdrejtë apo tërthorazi, së bashku ose në bashkëveprim me persona tjerë, dhjetë (10) përqind ose më tepër të çfarëdo klase të aksioneve me të drejtë vote të një IMF-je apo IFJB-je apo dhjetë (10) përqind të interesit në kapital në një IMF-je apo IFJB-je.

*20. Çfarë duhet të përgatitet për takimin informues?*

Para mbajtjes së takimit informues të interesuarit për aplikim duhet të përgatiten për të prezantuar në takim një përmbledhje të shkurtër të nivelit të lartë të propozimit të biznesit, që si minimum duhet të përmbajë:

- arsyeshmërinë e themelimit të IMF-së apo IFJB-së si dhe strategjinë fillestare të biznesit duke specifikuar se cilat produkte do të ofrohen, si do t'i ofrohen ato dhe tregun e synuar;
- burimet e financimit - si do të financohen dhe nëse kanë ndonjë investitor dhe/ose fonde në vend;
- pronësinë dhe ekipin menaxherial - detajet e pronarëve dhe menaxherëve të propozuar, për aq sa ato njihen;
- planin kohor - një pasqyrë dhe afat kohor të planit tuaj për të themeluar IMF-në apo IFJB-në e re.

*21. Kur mund të fillojë të përgatisë aplikacionin për regjistrimin e një IMF-je apo IFJB-je?*

Pas mbajtjes së takimit informues dhe dërgimit të formave për aplikim nga BQK, ju mund të filloni përgatitjen e aplikacionit për regjistrim si IMF apo IFJB në BQK.

*22. Çfarë dokumentesh duhet të dorëzohet si aplikacion për licencim/regjistrim të një IMF-je apo IFJB-je?*

Aplikacioni për regjistrim si IMF apo IFJB duhet të shoqërohet nga informacionet e kërkuara në pikën 2.2 të manualit për regjistrimin e IMF-ve dhe IFJB-ve. Kjo pjesë fillon me listimin e dokumenteve mbështetëse që duhet të jenë pjesë e aplikacionit për licencim/regjistrim si IMF apo IFJB.

*23. Sa shpejt mund të bëhem IMF apo IFJB?*

Nuk ka përgjigje të thjeshtë për këtë pyetje. Faza e para-aplikimit nuk ka një afat kohor të përcaktuar dhe shpejtësia e përparimit është tërësisht në vete dhe varet kryesisht nga serioziteti dhe angazhimi në plotësimin e dokumentacionit sipas kërkesave ligjore. BQK është e interesuar për cilësinë e materialit që ju përgatitni



më tepër sesa sasinë ose shpejtësinë në të cilën ju përgatiteni. Pasi të keni paraqitur kërkesën tuaj, BQK do të marrë një vendim për aplikimin tuaj brenda afatit ligjor prej nëntëdhjetë (90) ditësh - ju lutemi shihni fazën e Aplikimit për më shumë detaje.

#### 24. *Po sikur firma ime tashmë të jetë e licencuar/regjistruar?*

Nëse firma juaj tashmë është e licencuar/regjistruar për ndonjë aktivitet ju duhet të aplikoni për të shtuar veprimtaritë të cilat planifikoni të ushtroni. Përderisa ky është një lloj tjetër i veprimtarisë, ju duhet të ndiqni të njëjtin proces si një IMF apo IFJB e re dhe duhet të filloni me aktivitetet e para-aplikimit.

### **Para aplikimit**

#### 25. *A duhet të kaloj nëpër procesin e para-aplikimit?*

Po, ju duhet që të ndiqni procesin e para-aplikimit, kjo është kërkesë formale e BQK-së. Keni parasysh që firmat që janë më proaktive në fazën e para-aplikimit, paraqesin një kërkesë shumë më cilësore dhe BQK mund ta vlerësoj më lehtë.

#### 26. *Çka është plani i biznesit?*

Plani i biznesi është një përshkrim i biznesit tuaj të propozuar, që përmban detajet e objektivave tuaja dhe si do t'i arrini ato. Plani juaj i biznesit duhet të përshtatet me aktivitetet që firma juaj ka në plan të ndërmarrë duke marrë parasysh edhe kriteret e regjistrimit të BQK-së. Plani i biznesit, për të qenë i pranueshëm nga BQK, duhet minimalisht të përmbajë informatat e mëposhtme:

- pasqyrën e biznesit: strategjinë e përgjithshme të IMF-së apo IFJB-së së propozuar dhe detajet mbi veprimtarinë e planifikuar financiare;
- analizën e tregut duke përfshirë analizën e konkurrencës direkte dhe indirekte;
- analizën financiare ku përfshihet shpalosja e strukturës së aseteve, detyrimeve dhe kapitalit si dhe projeksionet financiare për tre vitet e para të operimit;
- funksionet e rëndësishme;
- strukturën udhëheqëse të IMF-së apo IFJB-së së propozuar.

Nëse paraqitni një plan biznesi të paplotë ose të paqartë, kjo do të shkaktojë vonesa në vlerësimin e aplikacionit tuaj, pasi BQK do të duhet të bëj pyetje të mëtejshme ose të kërkoj informacione të mëtejshme për të fituar një pasqyrë të qartë të biznesit tuaj. Megjithatë, plani juaj i biznesit edhe mund të evoluojë gjatë procesit të para-aplikimit, përderisa zhvillon modelin tuaj të biznesit dhe merrni komentet nga BQK. Plani i Biznesit është një pjesë e rëndësishme e aplikimit tuaj të përgjithshëm dhe është pjesë përbërëse e vendimmarrjes së BQK-së. BQK do ta përdor atë për të vlerësuar rreziqet që biznesi juaj i paraqet për objektivat tuaja dhe se si planifikoni t'i kontrolloni dhe menaxhoni ato. Ju gjithashtu duhet të përdorni planin tuaj të biznesit për të ju ndihmuar të fokusoheni në drejtimin e aktiviteteve tuaja dhe organizimin e burimeve për të arritur objektivin tuaj.

#### 27. *A janë ndërveprimet e mia me ju konfidenciale?*

Po. Të gjitha pyetjet dhe informatat që BQK pranon të trajtohen si konfidenciale.

28. *Sa është kapitali minimal i kërkuar për hapjen e një IMF-je apo IFJB-je të re?*

Kapitali minimal i kërkuar për hapjen e një IMF-je të re është 200 mijë euro. Ndërsa kapitali minimal i kërkuar për hapjen e një IFJB-je të re varet na numri i veprimtarive të planifikuara dhe atë si në vijim:

- Dhënja e kredive - 300,000 Euro;
- Lizingu/ lidhja e marrëveshjeve për hua dhe qira – 150,000 Euro;
- Këshilltar për investime – 100,000 Euro;
- Faktoringu – 150,000 Euro;
- Garancitë - 150,000 Euro;
- Shërbimi i pagesave - 100,000 Euro;
- Këmbimi i valutave - 10,000 Euro.

Për çdo IFJB që kërkojnë të angazhohen në më shumë se një aktivitet, kapitali minimal i kërkuar dhe mirëmbajtur do të jetë sipas shumave të përcaktuara për secilin aktivitet të kërkuar.

29. *Kush mund të jetë aksionar i IMF-së apo IFJB-së së re?*

Aksionar i bankave mund të jetë çdo person i cili është i përshtatshëm dhe i duhur si dhe vërteton qëndrueshmëri financiare.

30. *Çfarë prejardhje mund të kenë fondet për investim në formë të kapitalit?*

Kapitali minimal duhet të paguhet në paratë gatshme dhe se fondet e tij nuk mund të rrjedh nga aktivitetet joligjore dhe nga:

- kreditë nga bankat në të cilat bëhet pagesa e kapitalit; apo
- kreditë kur banka që pranon kapital është garantues;
- kreditë nga bankat tjera në Kosovë, përveç nëse janë të kolateralizuara njëqind për qind (100%) me letra me vlerë të aprovuara e që mbahen nga pala e tretë si kujdestar.

31. *A mund të lëshojmë aksione në këmbim të shërbimeve?*

Aksionet e lëshuara në këmbim të shërbimeve nuk trajtohen si kapital i paguar. Gjithashtu edhe pagesat ose shpenzimet për blerjen ose për qiramarrjen e lokaleve të punës dhe pajisjeve, si dhe shpenzimet e tjera operative nuk përfshihen në shumën e kapitalit fillestar minimal ose shumën minimale të depozitës në barasvlerën e kapitalit.

32. *Sa anëtar mund të ketë bordi i drejtorëve të një IMF-je apo IFJB-je?*

Bordi i drejtorëve përbëhet nga numri tek prej jo më pak se tre (3) anëtarë. Të gjithë anëtarët e bordit kanë të drejtë vote. Shumica e këtyre anëtarëve duhet të jenë drejtorë joekzekutiv të pavarur.

33. *A munden aksionarët të jenë anëtarë të bordit të drejtorëve?*

Po munden, vetëm duhet të kenë parasysh që shumica e këtyre anëtarëve duhet të jenë drejtorë joekzekutiv të pavarur.

34. *Cilët drejtorë mund të konsiderohen joekzekutiv?*

Çdo drejtor i cili nuk është menaxher i lartë apo punonjës në IMF apo IFJB, konsiderohet joekzekutiv.

35. *A mundet kryeshefi ekzekutiv të jetë anëtar i bordit të drejtorëve?*

Po, kryeshefi ekzekutiv mund të jetë anëtar i bordit të drejtorëve, mirëpo paraprakisht duhet të kërkojë miratim nga BQK. Pra, përveç miratimit nga BQK si kryeshef ekzekutiv, duhet të kërkojë miratim nga BQK që kryeshefi ekzekutiv të bëhet edhe anëtar i bordit të drejtorëve.

36. *Cilët drejtorë mund të konsiderohen të pavarur?*

Drejtor i pavarur, nënkuptohet drejtori që është i pavarur nga menaxhmenti i lartë apo personat e ndërlidhur me menaxhmentin e lartë.

37. *Çfarë do të thotë i përshtatshëm dhe i duhur për drejtorët dhe menaxherët e lartë?*

Përshtatshmëria e drejtorëve dhe menaxherëve të lartë të propozuar konsiderohet si thelbësore në procesin e BQK-së për licencimin/regjistrimin e IMF-ve apo IFJB-ve. Si pjesë e procesit të licencimit/regjistrimit rregullativa në fuqi kanë përcaktuar kriterin “i përshtatshëm dhe i duhur” dhe kriterin e pavarësisë për miratimin e drejtorëve dhe menaxherëve të lartë. Elementet të cilat merren në konsideratë për këto kritere përfshijnë: të dhënat mbi veprat penale, pozitën financiare, veprimet civile kundër individëve për ndjekjen e borxhit personal, refuzimi i anëtarësimit apo përjashtimi nga organizatat profesionale, sanksione të zbatuara nga rregullatorët e industrive të ngjashme dhe praktikrat e mëhershme të dyshimta të biznesit. Çdo aksionar kryesor, drejtor, menaxher i lartë duhet të përmbushin kërkesat për i përshtatshëm dhe i duhur, në lidhje me pozicionin përkatës.

38. *Kur, ku dhe si duhet ta dorëzohet aplikacionin për licencim/regjistrim të një IMF-je apo IFJB-je?*

Aplikacionin duhet ta dorëzoni, pasi që të kenë plotësuar dokumentacionin e nevojshëm për aplikim, në BQK në formë fizike dhe elektronike.

39. *Ku mund të lexoj më shumë për qasjen e BQK-së për regjistrimin e IMF-ve apo IFJB-ve?*

Për procesin e licencimit të bankave të reja ju mund të lexoni në Ligjin nr. 04/L-093 për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare (linku <http://www.bqk-kos.org/repository/docs/2012/Ligji%20per%20bankat%20IMF.pdf>) si dhe Manualin e Regjistrimit të IMF-ve apo IFJB-ve.

40. *A kam nevojë të punësoj këshilltarë ose konsulent të jashtëm për plotësimin e dokumentacionit për aplikim dhe kritereve tjera për licencimin/regjistrimin e një IMF-je apo IFJB-je?*

Kjo varet vetëm nga ju, por BQK nuk kërkon nga ju që ta bëni këtë. Shumë aplikues e vlerësojnë të dobishëm angazhimin e këshilltarëve të jashtëm ose konsulentëve, ndërsa të tjerët vlerësojnë se kanë nivelin e duhur të ekspertizës brenda stafit të tyre.

41. *A mund të rekomandoni ndonjë këshilltar ose konsulent të jashtëm?*

Jo, BQK nuk mund të rekomandojë ndonjë këshilltarë të veçantë të jashtëm ose konsulent.

*42. A mund t'i sjell këshilltarët e mi në takimet me ju?*

Po ju mund t'i sjellni, por BQK nuk pret që ata të flasin në emrin tuaj.

*43. A specifikoni cilat sisteme të TI duhet të përdorni?*

BQK nuk specifikon cilat sisteme të TI duhet të përdorni. Aktivitetet e rregulluara të firmës suaj duhet të mbështeten nga shërbimet e TI-së të cilat janë efektive, elastike dhe të sigurta si dhe janë të dizajnuara në mënyrë të përshtatshme për të plotësuar nevojat e ardhshme të pritshme, si dhe nevojat aktuale të biznesit.

*44. A mund të rekomandoni ndonjë sistem/ofruar të TI-së?*

Jo, BQK nuk mund të rekomandoj ndonjë sistem/ofruar të TI-së.

*45. Çfarë duhet të bëj nëse në ndërkohë gjatë aplikimit gjërat ndryshojnë?*

Nëse ka ndonjë ndryshim në lidhje me planet tuaja duhet të kontaktoni BQK-në më së largu pesë (5) ditë nga data e ndryshimit dhe të diskutoni për këto ndryshime.

*46. Sa është tarifa e licencimit bankar?*

Tarifa e regjistrimit të IMF-ve apo IFJB-ve është pesë mijë (5,000.00) Euro. Përrjashtim nga ky rregull kanë rastet kur aplikohet për regjistrim si Institucion Financiar Jobankar me aktivitet të vetëm këmbimin valutor e cila është dy mijë e pesëqind (2,500.00) Euro. Për më shumë shihni Skemën e Tarifave në ueb-faqen zyrtare të BQK-së (<http://bqk-kos.org/?id=88>)

*47. Ku mund të gjej detajet e tarifave të aplikimit?*

Të gjitha tarifat e kërkuara të aplikimit janë të paraqitura në Skemën e Tarifave që gjendet në ueb-faqen zyrtare të BQK-së (<http://bqk-kos.org/?id=88>) dhe janë të pakompensueshme, pa marrë parasysh vendimin e BQK-së. Nëse tarifa e licencimit/regjistrimit nuk është paguar, aplikacionet konsiderohen të pa kompletuara, dhe rrjedhimisht nuk shqyrtohen.

*48. Pse duhet të paguaj një tarifë?*

BQK financohet nga tarifat dhe taksat e mbuluara nga institucionet që licencen/regjistrojnë, rregullon dhe mbikëqyr. Si pjesë e kësaj kërkon një tarifë për shqyrtimin e një aplikimi për të licencuar/regjistruar një IMF apo IFJB të re.

## **Pas aplikimit**

*49. Çfarë ndodhë pas aplikimit në BQK për licencim/regjistrim si IMF apo IFJB?*

Pas dorëzimit formal të aplikacionit për licencim bankar, BQK bën vlerësimin e parë ku verifikohet nëse aplikacioni i dorëzuar është i plotë ose jo. Në mënyrë që aplikacioni të vlerësohet i plotë, të gjitha format e kërkuara duhet të dorëzohen në BQK. Këto forma duhet të jenë të plotësuara plotësisht, në mënyrë korrekte dhe informacioni i ofruar duhet të jetë i cilësisë dhe detajeve të mjaftueshme për të lejuar BQK-së

përfundimin e vlerësimit. Gjithashtu që të vlerësohet i plotë aplikacioni, duhet t'i ketë të inkuorporuara përgjigjet ndaj komenteve të BQK-së të ofruara gjatë fazës së para-aplikimit.

*50. Sa zgjatë vlerësimi i aplikacionit për licencim/regjistrim si IMF apo IFJB?*

BQK-ja brenda nëntëdhjetë (90) ditësh pas ditës së pranimit të aplikacionit, e shqyrton dokumentacionin e dorëzuar dhe e njofton aplikuesin me shkrim nëse dokumentacioni është apo nuk është kompletuar. Nëse dokumentacioni i paraqitur nuk është i kompletuar, BQK-ja do të njoftojë aplikuesin për mangësitë ose për mospërputhjet e identifikuar së bashku me kërkesën për informata ose dokumente shtesë që kërkohen. Afati për paraqitjen e informatave ose dokumenteve shtesë është jo me vonë se nëntëdhjetë (90) ditë pas njoftimit sipas këtij paragrafi. Nëse informatat ose dokumentet shtesë të kërkuara janë paraqitur brenda afatit, BQK do ta njoftoj palën se aplikacioni është i kompletuar. BQK-ja ndërpret procedurat e shqyrtimit të aplikacionit për regjistrim në rast se të dhënat dhe/ose dokumentacioni i kërkuar për regjistrim nuk plotësohet nga aplikuesi brenda nëntëdhjetë (90) ditësh nga data e njoftimit. Në rast të ndërprerjes së procedurës së shqyrtimit të aplikacionit për regjistrim, BQK-ja e njofton me shkrim aplikuesin. BQK-ja nxjerr vendim me të cilin aprovon apo refuzon licencimin/regjistrimin si institucion mikrofinanciar ose institucion financiar jobankar brenda nëntëdhjetë (90) ditësh nga data e njoftimit të aplikuesit se aplikacioni për licencim/regjistrim është i kompletuar. Për vendimin e marrë BQK-ja menjëherë e informon aplikuesin. Me marrëveshje të ndërsjellë ndërmjet BQK-së dhe aplikuesit, periudha për marrjen e vendimit mund të zgjatet deri në nëntëdhjetë (90) ditë të tjera.

*51. Cilat kushte duhet të plotësohen në mënyrë që aplikacioni për licencim/regjistrim si IMF apo IFJB të miratohet në BQK?*

BQK miraton regjistrimin e një IMF-je/IFJB-je vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

- nëse plani i biznesit bazohet në analiza të sakta mbi supozime të arsyeshme rrjedhimisht është real dhe konkurrues në treg;
- IMF/IFJB e propozuar do të veprojnë në pajtueshmëri me të gjitha dispozitat e Ligjit për Banka, IMF dhe IFJB;
- struktura organizative dhe struktura e pronësisë e propozuar do t'i lejojë BQK-së të ushtrojë mbikëqyrje efektive dhe të konsoliduar;
- kualifikimet, përvoja, integriteti dhe reputacioni i drejtorëve, drejtorit apo menaxherit të saj të lartë janë të përshtatshëm dhe të aftë për planin e biznesit së propozuar dhe veprimtarive financiare siç përcaktohet nga BQK-ja në nenin 35 dhe nenin 37 të Ligjit për Banka, IMF dhe IFJB dhe Udhëzimin nr.01/20115 për Verifikimin e të Kaluarës Penale për Aksionarët Kryesor, Drejtorët dhe Menaxherët e Lartë të Institucioneve Financiare;
- dëshmohet burimi i ligjshëm i fondeve të kapitalit, si dhe kapaciteti financiar për investimin e fondeve të planifikuara, si dhe për realizimin e financimeve të nevojshme për vazhdimin e qëndrueshëm të veprimtarisë së institucionit; dhe
- autoritete kompetente që mbikëqyrin institucionin financiar të huaj në selinë e saj kanë dhënë pëlqimin e tyre me shkrim për dhënien e regjistrimit të këtillë.

Me rastin e licencimit/regjistrimit, IMF-ja apo IFJB-ja e re duhet të fillojë veprimtarinë nga dita e njoftimit për licencim/regjistrim, në të kundërtën licencimi/regjistrimi i dhënë mund të revokohet.

*52. A ka ndonjë kusht tjetër që merret parasysh nga BQK si kriter për licencim/regjistrim në BQK?*

Jo, tjetër kriter licencimi/regjistrimi nuk ka mirëpo BQK-ja do të refuzojë një licencë/regjistrim, nëse nuk përmbushen kriteret e përcaktuara me Ligjin për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare, dhe Institucionet Financiare Jobankare dhe manual, nëse aplikuesi qëllimisht ka ofruar dokumentacion të falsifikuar dhe nëse gjykon se lëshimi i një licence të këtillë do të:

- vinte në rrezik qëndrueshmërinë financiare të IMF-së apo IFJB-së së propozuar ose të sistemit financiar në përgjithësi;
- rrezikonte interesat e depozitorëve të IMF-së së propozuar; apo zvogëlonte në mënyrë substanciale konkurrencën.

*53. Çfarë ndodhë nëse ndonjëra nga informatat e dorëzuara me aplikacion ndryshon gjatë periudhës së vlerësimit të aplikacionit tim në BQK?*

Në rast të ndryshimeve të informatave, mbi bazën e të cilave BQK ka lëshuar miratimin për licencim/regjistrim, aplikuesi për IMF apo IFJB të re njofton me shkrim BQK-në për faktet ose rrethanat e reja të krijuara. Ky njoftim duhet t'i dërgohet BQK-së menjëherë pas krijimit të rrethanave të reja, por jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas paraqitjes së tyre. Nëse ndryshimet që shfaqen gjatë fazës së organizimit ndryshojnë në mënyrë thelbësore faktet në të cilat BQK-ja e ka bazuar miratimin e saj, ai miratim mund të revokohet.

*54. A mund të apeloj nëse kërkesa për licencë/regjistrim refuzohet?*

Po, pala e pakënaqur mund të ushtroj padi (kundër vendimit të BQK-së për refuzim të kërkesës për licencë/regjistrim) pranë gjykatës kompetente në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga data e pranimit të vendimit, por ushtrimi i padisë nuk e ndalon zbatimin e tij.

*55. A mund të filloj organizimin para licencimit/regjistrimit?*

Aplikuesi mund të fillojë organizimin e IMF-së apo IFJB-së së re para se të licencohet/regjistrohet nga ana e BQK-së. Megjithatë, puna e IMF-së apo IFJB-së së re nuk mund të fillojë deri sa të jepet licencimi/regjistrimi nga BQK.

*56. Nëse institucioni është i autorizuar për të ushtruar veprimtari financiare, a mund të vazhdojë të ushtroj atë veprimtari edhe gjatë procesit të aplikimit?*

Po, institucioni mund të vazhdojë të kryej veprimtarinë për të cilin tashmë është autorizuar edhe gjatë procesit të aplikimit për licencë/regjistrim. Sidoqoftë, nuk mund të ushtrohen aktivitetet për të cilat institucioni po aplikon, derisa të bëhet autorizimi.